



KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 108/PROT
DATE 27.5.2019

AS-Audit Services sh.p.k
Adresa: Rr. "Kosovareve", Nr.33, H.2, Ap.7
Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë
Mobil: 068 20 99 204
E-mail: afrim.suli@outlook.com

Tiranë, më 23.05.2019

Lënda: Informacion për mosrealizimin e kontratës së auditimit për Partinë Aleanca për Europën (P.A.E).

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.112, datë 27.03.2019, jemi caktuar me detyrë të ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2018 për pesë Partitë Politike, midis të cilave ishte dhe Partia Aleanca për Europën(P.A.E).

Menjherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 23.04.2019, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë Aleanca për Europën(P.A.E), për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit të letrave rekomande, në adresën e selisë së partisë siç ishte përshkruar në dokumentin e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë drejtuar KQZ-së dhe në adresat që na dërgoi KQZ-ja në vazhdim,

Por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi letrat e dërguara rekomande u kthyen nga shërbimi postar me shpjegimin "adresë e pasaktë". U kërkua gjithashtu nga ekspertët parardhës në misionet të ngjashme numra telefoni apo e-maile të personave që ishin të lidhur me partinë, por dhe kjo nuk sollë rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kryetarin dhe personat e tjerë përgjegjës në parti, por kjo që e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë Aleanca për Europën(P.A.E), nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vertetues: Letra e dërguar dhe zarfi rekomande i kthyer nga shërbimi postar dhe pyetësoi udhëzues e kërkuar nga KQZ-ë.

Faleminderit për mirkuptimin.

Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)

(firma)

Afrim Suli

Tiranë, më 23.04.2019

Lënda: Për fillimin e procedurave të auditimit ligjor.

Për Partinë Aleanca për Europën(P.A.E)

Drejtuar kryetarit: z. Tomorr Imeri

Adresa e selisë: Rr. Don Bosko,Vila nr.155,Tiranë

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.112, datë 27.03.2019, jemi caktuar me clesine e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara nga Partia Aleanca për Europën(P.A.E) për vitin kalendarik 2018, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës së datës 23.04.2019, me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre" dhe afati kufi i përfundimit të procesit të auditimit është 22 Maj 2019.*

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabel për të na bërë të disponueshëm dokumentacionin kontabel,regjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.


Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar temat e angazhimit të auditimit. Përgjigjen drejtoheni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)

(Irrna)

Afrim Suli



Dërgon: Afrim Suli
Rruga e Kosovarëve, Nd. 35, H. 2, Ap. 7, 1019, Tiranë



RR 849 457 115 AA

33



Elia



100

Merr: Tomorr Imeri
Kryetar i Partisë Aleanca për Europën (P.A.E)
Rruga. Don Bosko, Vila nr. 155, Tiranë